



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Strehimores "Shtëpia e Sigurt" - Gjakovë Nr.01-360/09-42608 të datës 21.08.2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2026, të miratojë këtë:

PROPOZIM

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR STREHIMOREN "SHTËPIA E SIGURT" GJAKOVË

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00 € (pesë mijë euro), për ta mbështetur financiarisht Strehimoren "Shtëpia e Sigurt" në Gjakovë për mbulimin e pjesërishëm të shpenzimeve të Strehimores për ofrimin e mbështetjes së shërbimeve profesionale për fëmijët pa përkujdesje prindërore nga Komuna e Lipjanit të strehuar në shërbimin për fëmijë të Strehimores "Shtëpia e Sigurt" Gjakovë" në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Strehimores "Shtëpia e Sigurt" - Gjakovë Nr.01-360/09-42608 të datës 21.08.2026 dhe Aneksit I cili është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje .

II. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahen nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikuara për Drejtoratin për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2026, fondi burimor: 21/613/75511/200//1040.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale .

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim - Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Strehimores "Shtëpia e Sigurt" - Gjakovë Nr.01-360/09-42608 të datës 21.08.2026 dhe Aneksit I cili është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje .

Qëllimi i Marrëveshjes së lartëcekur të bashkëpunimit është vendosja e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe OJQ "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë për mbështetjen e ofrimit të shërbimeve profesionale shtesë për fëmijët pa përkujdesje prindërore nga Komuna e Lipjanit, të strehuar në Strehimoren **"Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë**.

Ky bashkëpunim synon që, përmes mbështetjes së Komunës së Lipjanit, të adresohen nevojat individuale të fëmijëve dhe të sigurohet qasje në shërbime profesionale të specializuara, të cilat plotësojnë shërbimet ekzistuese të ofruara në kuadër të Strehimores "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë.

Mbështetja e paraparë synon të kontribuojë në:

- përmirësimin e mirëqenies emocionale dhe psikologjike të fëmijëve;
- zhvillimin e aftësive individuale dhe sociale;
- mbështetjen në procesin edukativo-arsimor;
- rehabilitimin dhe fuqizimin e fëmijëve;
- përgatitjen dhe integrimin e tyre sa më të suksesshëm në komunitet.

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 400/01-46279
Lipjan, më 04.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





21.08.26

01-1366/01-42608



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA

OPŠTINA LIPLJAN

REPUBLIC OF KOSOVA

MUNICIPALITY OF LIPJAN

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

KOMUNËS SË LIPJANIT

dhe

Strehimores "SHTËPIA E SIGURT" – GJAKOVË

Në tekstin e mëtejme palët lidhin marrëveshje bashkëpunimi për mbështetjen e shërbimeve sociale, profesionale për fëmijët pa përkujdesje prindërore (pesë fëmijët) nga Komuna e Lipjanit, të strehuar në Strehimoren e licencuar për Fëmijë "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë me vendim të Qendres për Punë Sociale Lipjan

Neni 1

Palët nënshkruese

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, Z, Imri Ahmeti,

dhe

OJQ "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë, organizatë joqeveritare e licencuar për ofrimin e shërbimeve sociale, përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive, Erblina Dinarama

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

2.1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje është vendosja e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe OJQ "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë për mbështetjen e ofrimit të shërbimeve profesionale shtesë për fëmijët pa përkujdesje prindërore nga Komuna e Lipjanit, të strehuar në Strehimoren "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë.

2.2. Ky bashkëpunim synon që, përmes mbështetjes së Komunës së Lipjanit, të adresohen nevojat individuale të fëmijëve dhe të sigurohet qasje në shërbime profesionale të specializuara, të cilat plotësojnë shërbimet ekzistuese të ofruara në kuadër të Strehimores "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë.

Mbështetja e parapare përmes këtij Memorandumi synon të kontribuojë në:

- përmirësimin e mirëqenies emocionale dhe psikologjike të fëmijëve;
- zhvillimin e aftësive individuale dhe sociale;
- mbështetjen në procesin edukativo-arsimor;
- rehabilitimin dhe fuqizimin e fëmijëve;
- përgatitjen dhe integrimin e tyre sa më të suksesshëm në komunitet.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

3.1. Palët pajtohen që bashkëpunimi në kuadër të kësaj Marrëveshje të fokusohet në mbështetjen e shërbimeve profesionale për fëmijët pa përkujdesje prindërore nga Komuna e Lipjanit, të strehuar në shërbimin për fëmijë të Strehimores "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë.

Shërbimet e mbështetura mund të përfshijnë:

- shërbime psikologjike nga psikologu klinik;
- shërbime të logopedisë për fëmijët me nevojë specifike në zhvillim dhe komunikim;
- mbështetje profesionale nga ekspertë të fushave përkatëse sipas nevojave të fëmijëve;
- mbështetje në procesin e mësimin dhe integrimin shkollor;
- aktivitete edukative, sociale dhe rekreative;
- aktivitete për zhvillimin e aftësive jetësore dhe fuqizimin personal të fëmijëve;
- aktivitete dhe kurse profesionale sipas moshës dhe interesimit të fëmijëve.

3.2. Shërbimet do të planifikohen dhe realizohen në bazë të nevojave të identifikuara të secilit fëmijë, në bashkëpunim me profesionistët përgjegjës për menaxhimin e rasteve.

Neni 4

Përgjegjësitë e Komunës së Lipjanit

4.1. Komuna e Lipjanit, përmes drejtorisë përkatëse për shëndetësi dhe mirëqenie sociale përgjegjëse për shërbimet sociale dhe në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale në Lipjan, angazhohet që:

- të mbështesë financiarisht realizimin e aktiviteteve dhe shërbimeve profesionale të përcaktuara me këtë Memorandum, në pajtim me mundësitë buxhetore dhe legjislationin në fuqi;
- të bashkëpunojë me OJQ "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë dhe Qendrën për Punë Sociale në Lipjan për adresimin e nevojave të fëmijëve nga Komuna e Lipjanit;
- Përmes Qendrës për Punë Sociale në Lipjan, të sigurojë menaxhimin e rasteve, vlerësimin e vazhdueshëm të nevojave të fëmijëve, koordinimin e shërbimeve dhe monitorimin e progresit të tyre;

- Të lehtësojë koordinimin ndërinstitucional ndërmjet Qendrës për Punë Sociale në Lipjan, OJQ "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë dhe institucionet tjera relevante për realizimin e qëllimeve të kësaj Marrëveshje .

Neni 5

Përgjegjësitë e OJQ "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë

5.1. OJQ "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë angazhohet që:

- të sigurojë organizimin dhe realizimin e shërbimeve profesionale të përcaktuara me këtë Marrëveshje ;
- të angazhojë profesionistë të fushave përkatëse sipas nevojave të fëmijëve;
- të përdorë mjetet financiare vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje
- të mbajë dokumentacionin për aktivitetet e realizuara;
- të raportojë për realizimin e aktiviteteve dhe shfrytëzimin e mbështetjes financiare, sipas kërkesës së Komunës së Lipjanit.

Neni 6

Financimi

6.1. Komuna e Lipjanit, do të mbështesë financiarisht realizimin e shërbimeve profesionale shtesë të përcaktuara me këtë Marrëveshje , sipas nevojave të identifikuara të fëmijëve nga Komuna e Lipjanit, të strehuar në Strehimores "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë.

6.2. Buxheti i detajuar i aktiviteteve dhe shërbimeve që do të mbështeten është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje si **Aneksi I**.

6.3. Mjetet financiare të siguruara në kuadër të kësaj Marrëveshje nuk përfshijnë shpenzime të rregullta të jetesës, por janë të dedikuara për mbështetjen e shërbimeve profesionale, edukative dhe zhvillimore për fëmijët.

6.4. Kjo marrëveshje nuk pengon që Komuna e Lipjanit të ofroj mbështetje tjetër shtesë për nevojat e fëmijëve në strehim.

Neni 7

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

7.1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga Palët dhe zbatohet për vitin 2026 përkatësisht prej fillimit të ofrimit të shërbimeve.

7.2. Palët mund të pajtohen për vazhdimin e bashkëpunimit përmes një marrëveshjeje të re ose shtesës së këtij Memorandumi.

Neni 8

Monitorimi dhe raportimi

8.1. Palët do të bashkëpunojnë për monitorimin e zbatimit të kësaj Marrëveshje .

8.2. OJQ "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë do t'i ofrojë Komunës së Lipjanit informata mbi aktivitetet e realizuara dhe rezultatet e arritura, duke respektuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve.

8.3. Për zbatimin e marrëveshjes palët do të caktojnë personat përgjegjës për koordinimin dhe bashkëpunimin për realizimin e përgjegjësiave.

Neni 9

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

9.1. Palët obligohen që gjatë zbatimit të këtij Marrëveshje të respektojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.

9.2. Çdo informacion lidhur me fëmijët përfitues do të trajtohet me konfidencialitet të plotë dhe vetëm për qëllime të ofrimit dhe koordinimit të shërbimeve.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

10.1. Çdo paqartësi ose mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të këtij Memorandumi do të zgjidhet përmes komunikimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet Palëve.

Neni 11

Dispozitat përfundimtare

11.1. Kjo Marrëveshje shpreh vullnetin e përbashkët të Palëve për bashkëpunim në interesin më të mirë të fëmijëve pa përkujdesje prindërore nga Komuna e Lipjanit të strehuar në strehimoren e Fëmijëve Gjakovë sipas kërkesës dhe vlerësimit të Qendrës për Punë Sociale Lipjan

11.2. Kjo Marrëveshje hartohet në dy (2) kopje origjinale, nga një për secilën Palë, dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar.

Për Komunën e Lipjanit
Kryetari i Komunës

Z. Imri AHMETI

Data: _____

Vendi: _____

Për OJQ "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë
Drejtoresha Ekzekutive

Znj Erblina DINARAMA

Data: 24.08.2024

Vendi: LIPJAN

ANEKS I

KËRKESË PËR FINANCIM DHE BUXHETI I AKTIVITETEVE TË PLANIFIKUARA

I. Përshkrim i shkurtër i kërkesës për financim

OJQ "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë, në kuadër të Shërbimit për Fëmijë, aktualisht ofron mbështetje dhe mbrojtje për pesë fëmijët e familjes Pacolli nga Komuna e Lipjanit, të cilët janë të strehuar në Strehimoren "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë që nga muaji mars 2026.

Gjatë periudhës së qëndrimit të tyre në strehimore, përmes vlerësimeve profesionale të realizuara nga stafi i Shërbimit për Fëmijë, në bashkëpunim dhe koordinim me Qendrën për Punë Sociale në Lipjan, janë identifikuar nevoja specifike dhe të ndryshme për secilin fëmijë, të cilat kërkojnë mbështetje shtesë profesionale dhe zhvillimore.

Bazuar në vlerësimet e realizuara deri më tani, është evidentuar se fëmijët kanë nevojë për ndërhyrje të specializuara me qëllim të rehabilitimit, zhvillimit emocional, përmirësimit të aftësive komunikuese, mbështetjes në procesin edukativo-arsimor dhe përgatitjes për riintegrim sa më suksesshëm në komunitet.

Përkundër mbështetjes së vazhdueshme që ofrohet nga stafi profesional i Shërbimit për Fëmijë të Strehimores "Shtëpia e Sigurt" – Gjakovë, kapacitetet ekzistuese nuk mundësojnë mbulimin e të gjitha nevojave të identifikuara, veçanërisht për shërbime të specializuara nga profesionistë të jashtëm.

Për këtë arsye, kërkohet mbështetje financiare nga Komuna e Lipjanit për realizimin e shërbimeve profesionale dhe aktiviteteve shtesë për pesë fëmijët e familjes Pacolli, me qëllim të adresimit të nevojave të tyre individuale dhe krijimit të kushteve për zhvillim dhe ri integrim.

Mbështetja e kërkuar përfshin:

- shërbime logopedisë, pasi nga vlerësimet profesionale është evidentuar se të gjithë fëmijët kanë nevoja në fushën e zhvillimit të gjuhës dhe të folurit, përfshirë vështirësi në artikullim dhe komunikim;
- mbështetje nga psikologu klinik, për adresimin e nevojave emocionale, psikologjike dhe mbështetjen e procesit të përshtatjes dhe rehabilitimit;
- mbështetje edukative individuale, duke marrë parasysh vështirësitë e hasura në vazhdimin e shkollimit, përshtatjen në mjedisin shkollor, përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e shprehive të të nxëniet;
- aktivitete sociale, zhvillimore dhe rekreative, të cilat janë vlerësuar si të domosdoshme për socializmin, fuqizimin personal dhe zhvillimin e aftësive jetësore të fëmijëve;
- kurse dhe angazhime edukative jashtë shërbimeve të rregullta të strehimores, sipas moshës, interesimit dhe nevojave të fëmijëve;
- përfshirjen e fëmijës 5-vjeçar në kopsht, pasi nga vlerësimet profesionale është evidentuar vonesë në zhvillimin e gjuhës dhe vështirësi në ecurinë zhvillimore. Përfshirja në kopsht konsiderohet ndërhyrje e rëndësishme për stimulimin e hershëm zhvillimor, zhvillimin e komunikimit, socializimit dhe përgatitjen për procesin edukativo-arsimor.

Këto ndërhyrje synojnë që fëmijët të kenë qasje në mbështetje të specializuara dhe të përshtatur me nevojat e tyre, duke kontribuar në rehabilitimin, zhvillimin e potencialeve të tyre dhe krijimin e kushteve për ri integrim të qëndrueshëm.

2. Përshtatja e shërbimeve sipas nevojave të fëmijëve

Linjat buxhetore të paraqitura në këtë Aneks janë hartuar duke u bazuar në nevojat aktuale të identifikuar gjatë procesit të vlerësimit profesional dhe mbështetjes së vazhdueshme të fëmijëve.

Megjithatë, duke marrë parasysh se secili fëmijë ka nevoja individuale dhe se procesi i rehabilitimit dhe zhvillimit është dinamik, aktivitetet dhe shërbimet e planifikuara mund të përshtaten gjatë zbatimit të Memorandumit, në përputhje me rekomandimet profesionale dhe nevojat e reja të identifikuar.

Aktualisht, nevoja më e theksuar dhe e përbashkët për të gjithë pesë fëmijët është mbështetja për shërbime nga lokopedi, pasi nga vlerësimet e realizuara është evidentuar vonesë në zhvillimin e gjuhës dhe çrregullim i të folurit, përfshirë vështirësi në artikullim. Për këtë arsye, seancat logopedisë konsiderohen ndërhyrje e domosdoshme për përmirësimin e komunikimit, zhvillimin gjuhësor dhe përfshirjen më të lehtë të fëmijëve në proceset edukative dhe sociale.

3. Buxheti i propozuar

Nr. Përshkrimi i shpenzimit	Shuma (€)
1 Shërbime logopedisë për pesë fëmijët me qëllim të përmirësimit të zhvillimit të gjuhës, komunikimit dhe çrregullimeve të të folurit (artikullimit)	1,800 €
2 Angazhimi i psikologut klinik për vlerësim, mbështetje emocionale dhe psikologjike, si dhe punë individuale me fëmijët sipas nevojave të identifikuar	900 €
3 Mbështetje edukative individuale për vazhdimin e shkollimit, tejkalimin e vështirësive në mësim, përmirësimin e shprehjeve të të nxënës dhe përshtatjen në procesin arsimor	1,000 €
4 Aktivitete sociale, zhvillimore dhe rekreative, si dhe përfshirje në kurse dhe angazhime edukative jashtë shërbimeve të rregullta të strehimore	800 €
5 Përfshirja e fëmijës 5-vjeçar në kopsht dhe mbështetje për zhvillimin e hershëm, socializimit dhe përgatitjen për procesin edukativo-arsimor	500 €

TOTALI I KËRKUAR: 5,000 €